

## AKTI I THEMELIMIT

### I

#### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“FAQOLLI” Partners & Associates sh.p.k.

Themeluesit që nënshkruajnë më poshtë:

**1- Astrit Faqolli**, i biri i Hysenit, i datëlindjes 15/04/1970, lindur në Librazhd e banues në Tiranë, identifikuar me leternjoftimin ID nr. 034432796, Avokat, me Liçensë Profesionale nr. 10944, anëtar i Dhomës së Avokatëve Tiranë.

**2- Besa Llabunishti**, e bija e Pellumbit, e datëlindjes 18/01/1986, lindur e banues në Tiranë, identifikuar me pasaportën nr. BE 4939651, Avokat, me Liçensë Profesionale nr. 4484, anëtare e Dhomës së Avokatëve Tiranë;

Që në vijim do të quhen **Ortakë**,

Sot më datë 07.01.2021, bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendosën të themelojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“FAQOLLI” Partners & Associates sh.p.k**, me emrin tregtar **FAQOLLI**, në bazë të kushteve që vijojnë:

Kreu I

**OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1**

**Objekti i shoqërisë**

Shoqëria ka këtë objekt veprimtarie:

- Ushtrimin e veprimtarisë në fushën e avokatisë;
- Këshillime për çështje ligjore;
- Përgatitje të kërkesë-padive ose të kërkesave për ndjekje penale;

- Përgatitje të kërkesave ankimore kundër vendimeve gjyqësore, të prokurorisë, të arbitrazhit e të organeve të administratës shtetërore;
- Përgatitjen e ankesave e kërkesave të personave juridikë e fizikë;
- Konsulencë dhe përfaqësim të shoqërive tregtare;
- Perpilim i akteve qe vertetohen nga noteri.
- Hartimin e kontratave dhe marrëveshjeve, si dhe çdo dokument tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike;
- Pjesëmarrjen si mbrojtës gjatë ndalimit të personit dhe në hartimin e gjykimin e çështjeve penale;
- Përfaqësimin e palëve në të gjitha shkallët e gjyqësorit për gjykimin e çështjeve civile e administrative, si dhe ato në arbitrazh dhe në organe të tjera shtetërore për çështje administrative;
- Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- Keshillime per ceshtje ligjore.
- Konsulence dhe perfaqesim te shoqerive tregtare.
- Pjesemarrje si mbrojtës gjate ndalimit te personit dhe ne hartimin e gjykimin e ceshtjeve penale.
- Dhenia me qira dhe nen-qira e ambienteve.

## **Neni 2**

### **Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë**

2.1. Ortakët vendosën që shoqërinë ta emërtojnë:

**“FAQOLLI” Partners & Associates sh.p.k.**, me emrin tregtar **FAQOLLI**.

2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Rr.”Bulevardi Zhan Dark”, Pallati E88, ngjitur me restorant Çajupi, Hyrja 12, zyra nr, 8. Tiranë.

## **Neni 3**

### **Regjimi juridik**

3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtronhet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjisacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- 3.2 Shoqëria është e organizuar si Zyrë Avokatë e emërtuar “**FAQOLLI Partners & Associates sh.p.k.**”, me shkurtimin **FAQOLLI**, dhe ushtron aktivitetin e saj duke u bazuar gjithashtu në parashikimet e Ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë.”
- 3.3 Me vendim të saj, Asambleja e Ortakëve mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjisacionit shqiptar. Në ketë rast Ortakët do të përshtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë regjistrimin e saj në Registrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.
- 3.4 Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.
- 3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA**

**Neni 4**

#### **Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakeve**

- 4.1. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.2. Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar.
- 4.3. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.
- 4.4. Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.
- 4.5. Pasuritë e krijuara nga Zyra e Avokatisë gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj janë në pronësi të ortakëve, në raport me kapitalin themeltar të investuar prej tyre.
- 4.6. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike etj.

**Neni 5**

## **Kohëzgjatja**

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat të caktuar.

Kreu III

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

**Neni 6**

- 6.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **100.000** (njëqind mijë) **lek**, i ndarë në 2 (dy) kuota, i përbërë nga kontribute në para nga Ortakët themelues dhe i zotëruar në masën 100 % prej tyre, si më poshtë:
- Astrit Faqolli 1 (një) kuotë, 75 000 lekë përkatësisht 75 % të kuotave.
- Besa Llabunishti 1 (një) kuotë, 25 000 leke përkatësisht 25 % të kuotave.

Kreu IV

### **ORGANET E SHOQËRISË**

**Neni 7**

Vendimet në Shoqëri merren nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë. Këto vendime shënohen në Librin e Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar caktohet nga Asambleja e Ortakëve.

Kreu V

### **ADMINISTRIMI**

**Neni 8**

- 8.1 Administrimi i Shoqerise do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.
- 8.2 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga Administratori i saj, zoti **Astrit Faqolli** i cili do të qëndrojë në detyrë për një afat prej 5 (pesë) vjet me të drejtë riemërimi.

Kreu VI

## **DISPOZITA TË TJERA**

### **Neni 9**

- 9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakëve të shoqërisë.
- 9.2. Ky Akt shtypet dhe firmoset në 5 (pesë) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Besa Llabunishti**

*Besa Llabunishti*



**Astrit Faqollı**

*Astrit Faqollı*